

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburant

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

VLERA E FONDIT LIMIT: 12 500 000 (dymbëdhjet milion e pesëqind mije) leke Pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tropoje, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës Nr.3 (25.000 leke pa Tvsh)

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit shtojca 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a.Operatori ekonomik pjesmarres ne procedure te prokurimit duhet te jete i pajisur me licence te tregtimit me pakice te karburanteve ,gazit te lengshem ,te naftes,per automjetet ,vajrave lubrifikante dhe lendeve djegese per perdorim nga konsumatorët fundor , nga Qendra Kombetare e Liçencimit(QKL)ose Autorizim per ushtrim aktiviteti “Tregtim me pakice te lendeve djegese Karburante.

b.Pika e shitjes duhet te jete e pajisur me vertetim teknik per respektimin e kushteve teknike te leshuar nga ISHTI ose organet e miratuara te vleresimit te konfirmimitit (OMVK),leje mjedisore te tipit B ose C te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit(QKB), Akt teknik/Çertifikate e mbrojtjes nga zjarri leshuar nga pmmzsh dhe police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimit qe operojne ne Shqiperi per distributorët e shitjes me pakice,te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise ne daten e hapjes se ofertave .

c. Operatori ekonomik pjesmarres duhet te dorezoje aktin e Autorizimit per tregtimin e karburanteve dhe lendeve djegese te leshuar nga Bashkia

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 (**Kërkesat për kualifikim**) , pika 1/a dhe 2, të **LPP**, nenit 40, pika 5, të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe Mbeshtetur ne ligjin **Nr.** 8450 date 24/02/1999, "Per perpunimin, transportimin e naftes dhe nenprodukteve te tjera" , i ndryshuar. VKM **Nr.** 970, datë 2.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" **Keto kritere vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencen e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik**

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020-2021-2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 "Rekomandim mbi hartimin e kritereve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4, "Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave". Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM "Për rregullat e prokurimit publik", e cila parashikon se Autoriteti koonraktor per të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Konraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

b. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020-2021-2022**, të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur operatorët ekonomik ofertues janë në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika c, e ligjit nr.10091, datë.05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel. **Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Rekomandimi Nr. 1797/1 Prot., dt. 10.03.2022 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar “**Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare**”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese

c. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin 2023** (Sipas QKB) **(këstet e maturuara**, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. **Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipa shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor. **paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.**

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapacitetit teknik

. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.1. Operatori ekonomik pjesmarres ne procedure te prokurimit duhet te jete i pajisur me licence te tregtimit me pakice te karburanteve ,gazit te lengshem ,te naftes,per automjetet ,vajrave lubrifikante dhe lendeve djegese per perdorim nga konsumatorete fundor , nga Qendra Kombetare e Licencimit(QKL)ose Autorizim per ushtrim aktiviteti “Tregtim me pakice te lendeve djegese Karburante.

b.Pika e shitjes duhet te jete e pajisur me vertetim teknik per respektimin e kushteve teknike te leshuar nga ISHTI ose organet e miratuara te vleresimit te konfirmimitit (OMVK),leje mjedisore te tipit B ose C te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit(QKB), Akt teknik/Çertifikate e mbrojtjes nga zjarri leshuar nga pmnzsh dhe police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimit qe operojne ne Shqiperi per distributoret e shitjes me pakice,te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise ne daten e hapjes se ofertave .

c.Operatori ekonomik pjesmarres duhet te dorezoje aktin e Autorizimit per tregtimin e karburanteve dhe lendeve djegese te leshuar nga Bashkia.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të

thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

3. Operatori/et Ekonomik duhet te paraqesin dokumenta qe kane te bejne per fushen e çertifikimit dhe te inspektimit teknik te leshuara nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit

Ofertuesi/it duhet te paraqesin Flete analize ose raport analize te leshuara nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit.

Bazuar ne neni 75 pika 2 te ligjit nr.162, date 23.12.2020”Per ProkuriminPublik”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar Bazuar ne neni 75 pika 2 te ligjit nr.162, date 23.12.2020”Per ProkuriminPublik”dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

4.Subjekti Kontraktues duhet qe te kete pike te liçencuar furnizimi ne Qytetin e Tropojes.

- . Stacioni i tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur:
 - Autorizim lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë,
 - Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL,
 - Çertifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me dokumenta konkrete për permbushjen e këtyre kriterëve.

5. Subjekti ofertues duhet te paraqes listen e stacioneve te shitjes se karburanteve me pakice sipas adresave te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor, ku minimumi te kete 3(tre) stacione te shitjes me pakice,ne aksin Tropoje,Kukes,Has,,vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate qeraje ose akt pronesisie ose te jete te pasqyruara ne ekstraktin e regjistrimit tregetar leshuar nga QKB). Stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve detyrimisht duhen te jete i pajisur me Autorizim/Liçence leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice, leje

Mjedisore te tipit C leshuar nga QKL,Vertetim teknik leshuar ngaOrganet e Miratuara teVlersimit te Konfirmitetit(OMVK),Çertifikat e mbrojtjes nga zjarri ngaM.Z.SH,dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerit e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, per distributoret e shitjes me pakice, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmeri se daten e hapjes se ofetave

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr.8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve

të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie të licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”,

6.Subjekti ekonomik që shpallet fitues, duhet që të sigurojë dhe garantojë furnizimin me karta elektronike të personalizuar, të cilat mundësojnë identifikimin e targes së makinave /automjeteve dhe përdoruesin e saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

7.Ofertuesi /subjekti ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin 24 orë në çdo ditë të javës, deri në përfundim të kontratës, të furnizimit të plotë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

8.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e cilesisë së shërbimit **ISO 9001- 2015 Ose Ekuivalente** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e **ISO 14001: 2015 O Ose Ekuivalente** me të, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit. *vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).*

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente) (të vlefshme), në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes të zerave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Argumentimi: Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqip ose të jenë të përkthyer në shqip, si dhe origjinale ose të njohura me origjinalin (kopje të noterizuara). Çertifikatat duhet të jenë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një BO, operatorët duhet të disponojnë

certifikatat e kerkuara në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Shënim:

Në zbatim të Aktit Normativ nr.8 datë.25.03.2022, neni 21/ 5 si dhe neni 21/10 të aktit normativ nr.5 datë.12.03.2022 , OE pjesmarrëse mund të ofertojnë në vlerën që gjykojnë të arsyeshme por, përgjatë kohës së periudhës së situatës së veçantë çmimi që do të furnizohet autoriteti kontraktor do të jetë sa vlera e miratuar nga bordi i transparences në zbatim të aktit normativ të sipërcituar.

NJESIA E PROKURIMIT